



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

PËR VITIN 2019

Prishtinë, Korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga udhëheqësja e ekipit Erëmira Bytyqi Pllana dhe anëtarët e ekipit Refiqe Morina dhe Leonora Hasani, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Blerim Kabashi.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	7
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	14
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	17
Shtojca II: Letër Konfirmimi	20

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për këto Pasqyra. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pas ekzaminimit të hollësishëm të Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV), konkluzioni ynë është se procesi i përgatitjes së pasqyrave është menaxhuar në pajtim me legjislacionin në fuqi. PFV-të e Kuvendit të Republikës së Kosovës paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli në përgjithësi kishin kaluar nëpër procese efektive, me disa mangësi në fushën e ndarjes së subvencioneve dhe fushën e menaxhimit të kontratave për punë.

Zbatimi i rekomandimeve mund të ishte më i mirë. Nga dy rekomandime sa ishin dhënë në vitin 2018, një prej tyre ishte zbatuar pjesërisht, ndërsa një tjetër nuk ishte adresuar ende.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht, shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Administrata e Kuvendit të Kosovës është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar së do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, dhe për të siguruar dëshmitë që janë të nevojshme dhe që e mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjektet e audituara. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në faqen zyrtare të ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Ne vlerësojmë lart bashkëpunimin korrekt të menaxhmentit dhe stafit të Administratës së Kuvendit gjatë procesit të auditimit.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Megjithatë, fushat ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë planifikimi dhe realizimi i buxhetit për investime kapitale, fusha e ndarjes së subvencioneve dhe menaxhimi i kontratave për punë.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	11,219,281	8,578,315	8,099,896	94%	8,851,013	7,452,614

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Granti i Qeverisë - Buxheti	11,219,281	8,578,315	8,099,896	94%	8,851,013	7,452,614
-----------------------------	------------	-----------	-----------	-----	-----------	-----------

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 2,640,966€. Ky zvogëlim është rezultat i shkurtimeve buxhetore sipas vendimeve të Qeverisë³.

Në vitin 2019, Kuvendi ka shpenzuar 94% të buxhetit final ose 8,099,896€, apo për 751,117€ më pak krahasuar me vitin 2018. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	11,219,281	8,578,315	8,099,896	94%	8,851,013	7,452,614
Pagat dhe Mëditjet	7,136,281	6,179,200	6,175,249	99%	6,837,448	5,864,240
Mallrat dhe Shërbimet	2,212,000	1,505,000	1,278,149	85%	1,551,316	1,251,018
Shërbimet komunale	241,000	202,000	167,829	83%	179,444	197,632
Subvencionet dhe Transferet	140,000	105,000	103,360	98%	128,313	116,533
Investimet Kapitale	1,490,000	587,115	375,309	64%	154,492	23,191

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 957,081€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i vendimit të Qeverisë nr. 03/115 i datës 17.12.2019. Vlera e shpenzuar në këtë kategori ishte 6,175,249€;
- Buxheti për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 707,000€. Fillimisht në këtë kategori kishte pasur rritje në vlerë 17,600€ sipas vendimit të Ministrit të Financave nr.17/2019, ndërsa më pas kishte shkurtim të buxhetit si rezultat i vendimeve të Qeverisë, me ç'rast sipas vendimit 02/113 të datës 15.11.2019 ishte shkurtuar shuma prej 408,000€, ndërsa më pas sipas vendimit nr. 03/115 i datës 17.12.2019 ishte shkurtuar shuma prej 316,600€. Shpenzimet në këtë kategori ishin 1,278,149€;
- Buxheti për shërbime komunale ishte zvogëluar për 39,000€ në raport me buxhetin fillestar. Fillimisht, në këtë kategori kishte pasur rritje të buxhetit në vlerë 9,700€, sipas vendimit të Ministrit të Financave nr.17/2019, ndërsa më pas buxheti ishte zvogëluar sipas vendimit

³Vendimi nr. 02/113 i datës 05.11.2019 dhe vendimi nr. 03/115 i datës 17.12.2019

02/113 të datës 15.11.2019 në vlerë 27,000€, dhe sipas vendimit nr. 03/115 i datës 17.12.2019 në vlerë 20,700€. Shpenzimi në këtë kategori ishte 167,829€;

- Buxheti për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 35,000€. Ky zvogëlim ishte rezultat i vendimit të Qeverisë nr. 03/115 i datës 17.12.2019. Vlera e shpenzuar në këtë kategori ishte 103,360€; dhe
- Buxheti për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 902,885€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i vendimit të Qeverisë nr. 02/113 të datës 15.11.2019. Kjo vinte si rezultat i mos realizimit të projekteve kapitale të planifikuara të Kuvendit. Nga gjithsej 12 projekte të planifikuara në ligjin e buxhetit, shtatë prej tyre ishin vazhdim nga vitet paraprake, ndërsa pesë ishin projekte të reja për vitin 2019. Shtatë projekte nuk kishin filluar fare të realizohen, ndërkaq realizimi total i investimeve në raport me projektet e aprovuara në ligjin e buxhetit ishte 25%.

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje në vitin 2019 ishte 6,179,200€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 401, ndërsa numri i tyre në fund të vitit ishte 341. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 16 të rinj.

Ne kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 116,356€, si dhe tetë mostra për teste të pajtueshmërisë. Me rastin e ekzaminimeve tona, ne nuk kemi gjetur ndonjë parregullsi për t'u raportuar.

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 1,707,000€, prej të cilave ishin shpenzuar 1,445,978€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, shpenzimet e telefonisë mobile, dreka zyrtare, mirëmbajtje e ndërtesave, furnizime për zyrë dhe shërbimet komunale.

Në këtë kategori kemi testuar 43 mostra për teste substanciale në vlerë 375,361€ si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë. Me rastin e ekzaminimeve tona, ne nuk kemi gjetur ndonjë parregullsi për t'u raportuar.

2.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 105,000€, dhe prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 103,360€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me mbështetje për individë për qëllime shëndetësore, shkollim jashtë vendit, si dhe mbështetje ndaj OJQ-ve.

Ne kemi testuar pesë mostra për teste substanciale në vlerë 33,866€ si dhe tetë mostra për qëllime të pajtueshmërisë, nga të cilat janë identifikuar disa çështjet për t'u raportuar si më poshtë.

Çështja A1 Ndarja e subvencioneve për OJQ jashtë fushëveprimit dhe natyrës së aktiviteteve që është e paraparë t'i përkrah Kuvendi

Gjetja Sipas Rregullores nr.05/Rr-002 për shpenzimin e buxhetit të Kuvendit nga kategoria subvencione dhe transfere, neni 4, subvencionimi duhet të jetë vetëm në interes humanitar. Ndërsa pika 1.6 e këtij neni, specifikon emrat e organizatave joqeveritare të cilat mund të jenë përfitues të subvencioneve nga Kuvendi, fushëveprimi i të cilave janë aktivitetet humanitare.

Kuvendi kishte ndarë subvencione ndaj dy organizatave joqeveritare, fushëveprimi i të cilave nuk kishte të bëjë me aktivitete humanitare. Aktivitetet me të cilat merreshin këto OJQ, kishin të bëjnë me organizimin e festivalit të filmit si dhe organizimin e festivalit tradicional të komunitetit boshnjak.

Kjo kishte ndodhur, pasi kryesia e Kuvendit kishte vlerësuar të arsyeshme ndarjen e mjeteve ndaj këtyre dy OJQ-ve.

Ndikimi Ndarja e mjeteve për aktivitete të cilat janë jashtë kriterëve të rregullores në bazë të cilave Kuvendi ndan shuma të caktuara të subvencioneve, ndikon në shpenzimin e mjeteve në mos përputhje me qëllimin për të cilin janë aprovuar këto fonde.

Rekomandimi A1 Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit në bashkëpunim me Kryesinë e Kuvendit, të siguroj se përzgjedhja e përfituesve të mjeteve nga subvencionet bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara me rregullore.

Çështja A2 Monitorim jo i duhur i përfituesve të subvencioneve

Gjetja Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit mes Kuvendit dhe OJQ-së përfituese, kjo e fundit duhet të dorëzoj raportin mbi shpenzimin e mjeteve të pranuar nga Kuvendi.

- OJQ përfituese në vlerë 5000€, ende nuk kishte dorëzuar ndonjë raport mbi shpenzimin e mjeteve, ndonëse kishte kaluar më shumë se një vit nga periudha e përfitimit të mjeteve. Kjo pasi sipas OJQ-së përfituese, ende ishin në proces të realizimit të projektit.

Ndikimi Në mungesë të raporteve kthyesë nga përfituesit e subvencioneve, nuk është e mundur të konfirmohet nëse përfituesi ka shpenzuar fondet sipas qëllimit për të cilin është dhënë subvencioni.

Rekomandimi A2 Sekretari i Përgjithshëm të siguroj forcimin e kontrolleve në fushën e monitorimit të përfituesve të subvencioneve, për sigurimin e dëshmive përkatëse lidhur me shfrytëzimin e mjeteve nga OJQ-të, në përputhje me qëllimin e dhënë.

2.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 587,115€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 375,309€. Ato kanë të bëjnë me renovimin e ndërtesës së Kuvendit, digjitalizimin e arkivës së Kuvendit, krijimin e qendrës së të dhënave, sistemit të integruar WIFI.

Në këtë kategori, kemi testuar nëntë (9) mostra për teste substanciale në vlerë 375,309€, si dhe dy (2) mostra për teste të pajtueshmërisë, nga të cilat është identifikuar çështja për t'u raportuar si më poshtë.

Çështja A3 - Ndryshim i pozicioneve të kontraktuara në mungesë të aprovimit nga ZKA

Gjetja Bazuar në rregullat dhe udhëzuesin operativ për prokurimin publik, pika 61.19 menaxheri i projektit do të siguroj se Operatori Ekonomik (OE) kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Po ashtu, pika 61.23 thekson se ndryshimi i kontratës nuk do t'i lejohet OE para marrjes së aprovimit nga ZKA.

Në kontratën "Renovimi i ndërtesës së Kuvendit", menaxheri i projektit së bashku me organin mbikëqyrës kishte konfirmuar pranimin e situacionit të parë në vlerë 14,470€. Megjithatë, kjo pagesë nuk ishte çertifikuar nga departamenti i financave për shkak se punët e kryera në këtë situacion, në një pozicion në vlerë 7000€, nuk ishin bërë sipas specifikave të kontratës dhe nuk ishin të aprovuara paraprakisht nga ZKA.

Këtë ndryshim të pozicionit në kontratë, organi mbikëqyrës e kishte arsyetuar se ishte një zgjidhje më funksionale dhe më e sigurt për të cilën nuk kishte kosto shtesë. Ndërsa, menaxheri i projektit e kishte konfirmuar pranimin e punëve duke u bazuar në një aprovim paraprak nga ZKA, që ishte marrë në vitin 2015 dhe që kishte të bëjë me pozicionin e njëjtë por ishte kontratë tjetër, ndërsa nuk kishte qenë i informuar se do të duhej që për kontratën aktuale të merrej sërish aprovim nga ZKA.

Si pasojë e kësaj, pagesa në vlerë 7000€, ishte ekzekutuar nga Thesari në llogari të operatorit ekonomik, sipas urdhërit të përmbauesit, duke shkaktuar kosto shtesë në vlerë 1,050€ për shpenzime të procedurës përmbauese.

Ndikimi Ndryshimi i pozicioneve të kontraktuara, në mungesë të marrjes së aprovimit paraprak nga ZKA, ka ndikuar që pagesa të bëhet përmes përmbaruesit, duke shkaktuar shpenzime financiare shtesë.

Rekomandimi A3 Sekretari i Përgjithshëm, duhet të siguroj se kryerja/pranimi i punëve bëhet sipas pozicioneve të kontraktuara, në të kundërtën, ndryshimet e pozicioneve duhet të aprovohen paraprakisht.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 5,825,675€, pasurive jokapitale 267,907€, si dhe e stoqeve 19,104€. Ne kemi testuar 14 mostra për teste substanciale në vlerë 372,362€, si dhe 11 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Po ashtu, kemi shqyrtuar edhe mirëmbajtjen e regjistrave të pasurive, nga të cilat është identifikuar çështja për t'u raportuar si më poshtë.

Çështja B1 - Mos regjistrimi i objektit bazë të Kuvendit të Kosovës

Gjetja Sipas Rregullores MF nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK.

Në regjistrin kontabël të pasurive të Kuvendit të Kosovës, nuk ishte regjistruar objekti në të cilin operon Kuvendi i Kosovës.

Kjo kishte ndodhur pasi, pavarësisht marrjes së masave nga administrata e Kuvendit për të lidhur një kontratë me një operator ekonomik për vlerësimin e objektit që nga viti 2018, procedurat kishin dështuar për shkak të ankesave në OSHP. Megjithatë, Kuvendi ishte sërish në procedura të prokurimit për të lidhur një kontratë të tillë.

Ndikimi Mos regjistrimi i objektit të Kuvendit në regjistrat e pasurive kapitale ndikon në nënvlerësimin domethënës të pasurive kapitale që i zotëron Kuvendi.

Rekomandimi B1 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që objekti i Kuvendit të Kosovës i trashëguar si pasuri kapitale, të regjistrohet sa më parë në regjistër të pasurisë.

2.3 Detyrimet

2.3.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2019, ishte 82,291€. Ato kishin të bëjnë me shërbime komunale, dreka zyrtare, shpenzime të telefonisë mobile, derivate për automjete dhe shpenzimet e udhëtimeve zyrtare. Arsyeja e mos pagesës ishte për shkak të mbylljes së vitit fiskal. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020.

2.3.2 Detyrimet kontingjente

Pasqyra e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2019, ishte 188,676€. Ato kishin të bënin me padi për kompensim dëmi dhe konteste pune.

2.3.3 Detyrimet kontraktuese

Vlera e detyrimeve kontraktuese të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që pritet të realizohen në vitet e periudhës 2020-2022 është 1,273,429€.

2.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një auditor. NjAB në përputhje me planin strategjik kishte përgatitur planin vjetor për vitin 2019, ku kishte planifikuar dhe kishte kryer pesë auditime të rregullta dhe një me kërkesë. Përmes raporteve të auditimit, menaxhmentit i janë ofruar informata në lidhje me funksionimin e sistemit financiar dhe vlerësime për funksionimin dhe efikasitetin e kontrolleve të brendshme.

Komiteti i Auditimit kishte mbajtur tri takime gjatë vitit 2019. Në ato takime ishin vlerësuar dhe trajtuar çështjet e paraqitura në raportin e auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2018 si dhe çështjet e ngritura nga auditimi i brendshëm.

Auditori i Brendshëm kishte dhënë gjithsej 16 rekomandime, prej të cilave tri (3) ishin zbatuar, tetë (8) ishin zbatuar pjesërisht, ndërsa pesë (5) nuk ishin zbatuar.

Fushat e mbuluara kishin të bëjnë me menaxhimin e buxhetit, prokurimin, menaxhimin e personelit dhe arkivës, ndërsa periudhat mbulonin vitin 2018 dhe 2019.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të Kuvendit të Republikës së Kosovës ka rezultuar në dy rekomandime kryesore. Kuvendi kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Kuvendi ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve me 30 shtator sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit, ndërsa për gjashtë-mujorin e dytë që është dashur të dorëzohet me 15 mars, është dorëzuar me vonesë, përkatësisht me 3 qershor 2020.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, një (1) rekomandim ishte në proces dhe një (1) tjetër nuk ishte adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr.4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se është bërë një vlerësim i shkaqeve në lidhje me pengesat e hasura në procesin e realizimit të projekteve kapitale, si dhe të nxjerrin mësimet në mënyrë që praktikatat e tilla të mos përsëriten. Performanca e projekteve kapitale duhet të monitorohet në baza mujore dhe të adresohen barrierat e identifikuar me kohë, në realizimin e projekteve kapitale.	Në krahasim me vitin e kaluar ka përmirësim në realizimin e projekteve megjithatë edhe këtë vit realizimi është i ulët.	Rekomandim në proces të zbatimit
2	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që objekti i Kuvendit të Kosovës i trashëguar si pasuri kapitale, të regjistrohet në regjistër të pasurisë.	Kuvendi ka ndërmarrë veprime por për shkak të ankesave në OSHP nuk ka mundur të lidh kontratë për vlerësimin e pronës. Deri më tani jemi njoftuar se aktualisht janë në procedura të lidhjes së kontratës.	Rekomandim i pazbatuar
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
A1	Subvencionet dhe transferet	Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit në bashkëpunim me Kryesinë e Kuvendit, të siguroj se përzgjedhja e përfituesve të mjeteve nga subvencionet bëhet në përputhje me natyrën e aktiviteteve për të cilat janë aprovuar këto mjete.		
A2	Subvencionet dhe transferet	Sekretari i Përgjithshëm të siguroj forcimin e kontrolleve në fushën e monitorimit të përfituesve të subvencioneve, për sigurimin e dëshmimeve përkatëse lidhur me shfrytëzimin e mjeteve nga OJQ-të, në përputhje me qëllimin e dhënë.		
A3	Investimet Kapitale	Sekretari i Përgjithshëm, duhet të siguroj se kryerja/pranimi i punëve bëhet sipas pozicioneve të kontraktuara, në të kundërtën ndryshimet e tyre duhet të aprovohen paraprakisht.		

B1	Pasuritë kapitale dhe jokatitale	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që objekti i Kuvendit të Kosovës i trashëguar si pasuri kapitale, të regjistrohet sa më parë në regjistër të pasurisë.
----	----------------------------------	--

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër Konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

IVËNËRI I KOSOVËS SECRETARIA	SKUPŠTINA E KOSOVËS SECRETARIAT	ASSEMBLY OF KOSOVO SECRETARIAT
Nr. <u>I241/20</u> ZS		
Dt. <u>06.07</u> <u>2020</u>		
Prishtinë - Pristina		

LETËR KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e Auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

I/e nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Komëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti"),
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit, dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

për 
Ismet Krasniqi

Sekretar i Përgjithshëm - Kuvendi i Republikës së Kosovës

Datë: 6 korrik 2020, Prishtinë.